



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ DATË ____ / ____ /2025

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 16, DATË 21.05.2025 PËRSA I PËRKET ZNJ. DAJANA LUMI, Z. LIRIM MURRJA DHE Z. MENTOR MUJA

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 “Për miratimin e ndryshimit të vendimit nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr. 1032, Rruga “Aleks Komneni” dhe Pallatin “Kastrati”, Rruga “Ramadan Veliu” të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, të ndryshuar, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë Durrës “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, i ndryshuar si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë dhe miratojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe

TË VENDOSË:

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 përsa i përket shpalljes si përfituese të znj. Dajana Lumi sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 76, datë 28.06.2021 dhe sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 përsa i përket shpalljes si përfitues të z. Lirim Murrja sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30,

datë 26.03.2021 dhe sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.

3. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 përsa i përket shpalljes si përfitues të z. Mentor Muja sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 76, datë 28.06.2021 dhe sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit si dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

ZËVENDËSKRYETAR


Elio Jani

SPECIALIST



Enli Kaculi

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtör


Ardian Hjazaj

KRYETAR


Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE DS4-DS5

RELACION

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 16, DATË 21.05.2025 PËRSA I PËRKET ZNJ. DAJANA LUMI, Z. LIRIM MURRJA DHE Z. MENTOR MUJA

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr. 22, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, VKM-së nr. 329, datë 16.05.2021 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” si dhe Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë Durrës “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5” i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 mori në shqyrtim ankesat e mwposhtme:

1. Znj. Dajana Lumi banuese në Durrës.

Znj. Dajana Lumi me nr. ID J75613078P është shpallur përfituese me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 76, datë 28.06.2021 por më pas është hequr nga lista me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 me arsyen se rezulton me pasuri tjetër.

Subjekti i është drejtuar Institucionit të Bashkisë Durrës me ankesën nr. 7906 prot., datë 27.06.2025 dhe me ankesën e dërguar nga Studio Ligjore Petani me nr. 6443 prot., datë 29.05.2025 pasi nuk është dakort me përjashtimin si përfituese e banesës së dëmtuar dhe kërkon t'i rikthehet shtëpia me pretendimin se nuk disponon banesë tjetër.

Në shqyrtimin e ankesës Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 vëren se aplikimi është bërë nga znj. Dajana Lumi sipas kërkesës me nr. 226 prot., datë 22.02.2020, e cila është regjistruar me nr. 29390 në regjistrin elektronik të të dhënave. Në dosjen e aplikantit të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike me nr. 6443/2 prot., datë 18.06.2025 me kërkesë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, ndodhen këto dokumenta:

Akt Konstatim.

Certifikatë familjare me përbërje 4 persona (Agim Lumi, Flora Lumi, Dajana Lumi, Daniele Lumi), lëshuar me datë 22.02.2020.

Fotokopje e kartës së ID Dajana Lumi.

Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. pas 5/979+1-3, ZK. 8513, vol. 65, fq. 36, lloji i pasurisë apartament me sip. totale 116.30 m², në pronësi të znj. Dajana Lumi, lëshuar me datë 14.06.2019. shoqëruar me Hartën Treguese të Regjistrimit.

Më pas me anë të ankesës janë dërguar pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5: Prokurë e Posaçme me nr. rep 1187, nr. kol 862, datë 27.05.2025.

Certifikatë personale e znj. Dajana Lumi, datë 22.05.2025.

Certifikatë regjistrimi pronësie me nr. pas 28/92/ND, ZK. 8512, me sip. totale 87m², lloji i pasurisë ndërtesë në emër të z. Agim Lumi, lëshuar me datë 24.06.2021.

Certifikatë familjare me përbërje 2 persona (Dajana Lumi dhe Glauk Lumi), lëshuar me datë 22.05.2025.

Certifikatë familjare me përbërje 6 persona (Familja Gjura), lëshuar me datë 23.05.2025.

Certifikatë familjare me përbërje 3 persona (Agim Lumi, Flora Lumi, Daniele Lumi), lëshuar me datë 23.05.2025.

Vërtetim nga ASHK që vërteton se pas verifikimit të kryer në sistemin Multifunksional për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në DV-ASHK Durrës rezulton se pasuria nr. 5/979+1-3, vol. 65, fq. 36, zk. 8513, lloji i pasurisë apartament rezulton në pronësi të Dajana Lumi.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 në trajtimin e ankesës vëren se strukturat e ngritura në kuadër të Rindërtimit pra Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit në trajtimin e rastit në fjalë kanë arsyetuar duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” dhe duke evidentuar

faktin (nga strukturat përkatëse) të përbërjes familjare (4 persona) kanë klasifikuar familjen e znj. Dajana Lumi përfituese të njësisë së banimit me strukturë 2+1, evidentuar kjo me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 76, datë 28.06.2021. Nga Komunikimi me Zyrën e Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike konstatojmë se nga korrespondenca që kanë patur me ASHK-në, kjo e fundit me shkresën nr. 1830/1 prot., datë 01.04.2025 konfirmon se znj. Dajana Lumi ka edhe një pronë tjetër me funksion banimi, për këtë arsye është marrë vendim për heqjen si përfituese pasi rezulton me pasuri tjetër. Në bazë të dokumentacionit të dërguar pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 rezulton se znj. Dajana Lumi ka në pronësi vetëm një apartament me nr. pas 5/979+1-3, ZK. 8513, vol. 65, fq. 36, lloji i pasurisë apartament me sip. totale 116.30 m², vërtetuar kjo edhe nga ASHK me vërtetimin nr. 9981 prot., datë 20.06.2025.

Sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4 – DS5 referuar dokumentacionit që disponon gjatë shqyrtimit administrativ, Aktit Normativ nr. 9 si dhe legjislacionit në fuqi propozon që praktika e znj. Dajana Lumi t'i kalohet Këshillit Bashkiak Durrës i cili pas trajtimit të rastit të shqyrtojë propozimin e Komisionit për përfshirjen e znj. Dajana Lumi në listën e përfituesve për njësinë e banimit.

Sa më sipër sqarojmë se kundër këtij vendimi mund të ankimohet në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

2. Z. Lirim Murrja banues në lagjen nr. 17, rruga “Ramadan Veliu”, Durrës.

Z. Lirim Murrja me nr. ID G90605087J është shpallur përfitues me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 por më pas është hequr nga lista me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 me arsyen se rezulton me pasuri tjetër.

Subjekti i është drejtuar Institucionit të Bashkisë Durrës me ankesat nr. 7900 prot., datë 27.06.2025, nr. 6465 prot., datë 29.05.2025 dhe nr. 8096 prot., datë 01.07.2025 pasi nuk është dakort me përjashtimin si përfitues për banesën e dëmtuar dhe kërkon t'i rikthehet shtëpia me pretendimin se nuk disponon banesë tjetër.

Në shqyrtimin e ankesës Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 vëren se aplikimi është bërë nga z. Argjend Murrja sipas kërkesës me nr. 263 prot., datë 20.02.2020, e cila është regjistruar me nr. 26555 në regjistrin elektronik të të dhënave. Në dosjen e aplikantit të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike me nr. 6465/2 prot., datë 18.06.2025 me kërkesë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, ndodhen këto dokumenta:

Fotokopje e pasaportës së z. Argjend Murrja.

Akt Konstatim.

Certifikatë familjare me përbërje 5 persona (Lirim Murrja, Shadije Zili, Oligerta Murrja, Argjend Murrja, Ameis Xheja), lëshuar me datë 20.02.2020.

Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. pas 5/979-ND+3-34, ZK. 8513, vol. 65, fq. 138, lloji i pasurisë apartament me sip. totale 104.2 m², në pronësi të Lirim Murrja dhe Shadije Zili, lëshuar me datë 04.04.2014. Shoqëruar me Hartën Treguese të Regjistrimit.

Vërtetim nga ASHK që vërteton se nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSCAD), rezulton se në emër të shtetasit Lirim Murrja nuk ka pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme, lëshuar me datë 30.06.2025

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 në trajtimin e ankesës vëren se strukturat e ngritura në kuadër të Rindërtimit pra Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit në trajtimin e rastit në fjalë kanë arsyetuar duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” dhe duke evidentuar faktin (nga strukturat përkatëse) të përbërjes familjare (5 persona) kanë klasifikuar familjen e z. Lirim Murrja përfitues të njësisë së banimit me strukturë 3+1, evidentuar kjo me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 30, datë 26.03.2021. Nga Komunikimi me Zyrën e Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike konstatojmë se nga korrespondenca që kanë patur me ASHK-në, kjo e fundit me shkresën nr. 1830/1 prot., datë 01.04.2025 konfirmon se z. Lirim Murrja ka edhe një pronë tjetër me funksion banimi, për këtë arsye është marrë vendim për heqjen si përfitues pasi rezulton me pasuri tjetër. Duke marrë parasysh vërtetimin e ASHK-së datë 30.06.2025 të dërguar pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 rezulton se z. Lirim Murrja nuk ka pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.

Sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4 – DS5 referuar dokumentacionit që disponon gjatë shqyrtimit administrativ, Aktit Normativ nr. 9 si dhe legjislacionit në fuqi propozon që praktika e z. Lirim Murrja t’i kalohet Këshillit Bashkiak Durrës i cili pas trajtimit të rastit të shqyrtojë propozimin e Komisionit për përfshirjen e z. Lirim Murrja në listën e përfituesve për njësinë e banimit.

Sa më sipër sqarojmë se kundër këtij vendimi mund të ankimohet në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

3. Z. Mentor Muja banues në lagjen nr. 17, rruga “Ramadan Veliu”, Durrës.

Z. Mentor Muja me nr. ID I008252090 është shpallur përfitues me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 76, datë 28.06.2021 por më pas është hequr nga lista me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 me arsyen se rezulton me pasuri tjetër.

Subjekti i është drejtuar Institucionit të Bashkisë Durrës me ankesat nr. 7891 prot., datë 27.06.2025 dhe nr. 7389 prot., datë 19.06.2025 pasi nuk është dakort me përjashtimin si përfitues për banesën e dëmtuar dhe kërkon t'i rikthehet shtëpia me pretendimin se nuk disponon banesë tjetër pasi prona e dytë është me kontratë Kapari që në vitin 2016 dhe është paguar deri më tani $\frac{3}{4}$ e pronës e cila rezulton e bllokuar pasi jeton familja blerëse.

Në shqyrtimin e ankesës Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 vëren se aplikimi është bërë nga z. Mentor Muja sipas kërkesës me nr. 78 prot., datë 10.02.2020, e cila është regjistruar me nr. 13912 në regjistrin elektronik të të dhënave. Në dosjen e aplikantit të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike me nr. 8218/1 prot., datë 11.07.2025 me kërkesë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, ndodhen këto dokumenta:

Akt Konstatim.

Certifikatë familjare me përbërje 4 persona (Mentor Muja, Trëndafile Muja, Nevin Muja, Albjona Muja), lëshuar me datë 07.02.2020.

Kontratë sipërmarrje me porositës z. Mentor Muja dhe sipërmarrës Kastrati sh.a.

Më pas me anë të ankesës janë dërguar pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5:

Kontratë Kapari me nr. 1401 Rep dhe nr. 778/1 Kol, datë 11.07.2016.

Fotokopje e katrës së ID së z. Mentor Muja, znj. Trëndafile Muja dhe z. Nevin Muja.

Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. pas 5/141, ZK. 2574, vol. 18, fq. 132, lloji i pasurisë arë me sip. totale 315 m², në pronësi të z. Mentor Muja, lëshuar me datë 10.11.2015. Shoqëruar me Hartën Treguese të Regjistrimit.

Faturë e FSHU në emër të znj. Gjyslime Murati, gusht 2021.

Fotokopje e librezës së OSHEE.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 në trajtimin e ankesës vëren se strukturat e ngritura në kuadër të Rindërtimit pra Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit në trajtimin e rastit në fjalë kanë arsyetuar duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” dhe duke evidentuar faktin (nga strukturat përkatëse) të përbërjes familjare (4 persona) kanë klasifikuar familjen e z. Mentor Muja përfitues të njësisë së banimit me strukturë 2+1, evidentuar kjo me Vendimin e

Këshillit Bashkiak Durrës nr. 76, datë 28.06.2021. Nga Komunikimi me Zyrën e Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike konstatohet se nga korrespondenca që kanë patur me ASHK-në, kjo e fundit me shkresën nr. 1830/1 prot., datë 01.04.2025 konfirmon se z. Mentor Muja ka edhe një pronë tjetër me funksion banimi, për këtë arsye është marrë vendim për heqjen si përfitues pasi rezulton me pasuri tjetër. Duke marrë parasysh Kontratën e Kaparit të dërguar pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 me nr. 1401 Rep dhe nr. 778/1 Kol, datë 11.07.2016 ky komision konstaton se me përfundimin e kësaj kontrate z. Mentor Muja i hiqet e drejta e pronësisë.

Sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4 – DS5 referuar dokumentacionit që disponon gjatë shqyrtimit administrativ, Aktit Normativ nr. 9 si dhe legjislacionit në fuqi propozon që praktika e z. Mentor Muja t'i kalohet Këshillit Bashkiak Durrës i cili pas trajtimit të rastit të shqyrtojë propozimin e Komisionit për përfshirjen e z. Mentor Muja në listën e përfituesve për njësinë e banimit.

Sa më sipër sqarojmë se kundër këtij vendimi mund të ankimohet në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE DS4-DS5

ELJO JANI

ARDJAN ILJAZAJ

ENLI KACULI